

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Aluizni Tiranë me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” për periudhën 01.01.2009 –30.04.2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 13, datë 03.02.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 200/8, datë 03.02.2012, dërguar z. **Arjan HASANI**, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Aluizni Fier, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. KËSHILLIT TË MINISTRAVE PROPOZIM PËR PËRMIRSIM NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. nga kontrolli i zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve paleje” i ndryshuar, ka rezultuar se çmimi i sipërfaqeve me madhësi të ndërmjetme nga sipërfaqet e përcaktuara në nenet 19, 20, 21 e 22 të këtij ligji, është përcaktuar në bazë të VKM nr. 1180, datë 05.08.2008 “Për përcaktimin e vlerës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimit të ardhurave të procesit të legalizimit” pika 4.1, si dhe manualit të procedurave të bazuara në VKM nr. 1180, datë 05.08.2008, i cili është më i vogël nga çmimi që përcakton ligji. Kjo ka sjellë si pasojë zvogëlimin e çmimit për sipërfaqet e parcelave ndërtimore të zëna të madhësisë të ndërmjetme nga sipërfaqet e përcaktuara në ligj.

Duke u nisur nga ky konstatim i:

PROPOZOJMË

Këshillit të Ministrave që, në VKM nr. 1180, datë 05.08.2008 “Për përcaktimin e vlerës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimit të ardhurave të procesit të legalizimit”, të shfuqizojë pikën 4.1, sipas së cilës, “Për objektet informate me funksion banimi, kur sipërfaqja e parcelës ndërtimore është e një madhësie të ndërmjetme nga sipërfaqet e përcaktuara në nenet 19, 20, 21 e 22, pagesa për të, do të jetë shumë e vlerës më të vogël në lekë, plus vlerën shtesë, që del nga llogaritja me interpolim për sipërfaqen shtesë” e parashikuar kjo nga nenet 19, 20, 21 e 22 të ligjit dhe që është e papajtueshme me nenin 46 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 ku nenet 19, 20, 21 e 22 të ligjit nuk përfshihen në të drejtat që i jepen Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë përkatëse për marrje vendimesh e nxjerrje udhëzimesh për procesin.

B. MASA ORGANIZATIVE.

1-Të kërkohet në rrugë ligjore nga njësitë e pushtetit vendor dorëzimi i dosjeve për legalizim praën Drejtorisë Rajonale të ALUIZNIT, Fier, në njësitë ku nuk është kryer dorëzimi dhe procesi nuk ka filluar, konkretisht për njësitë :

- Komuna Ruzhdie 146 dosje
- Komuna Ballagat 76 dosje
- Komuna Dushk 680 dosje
- Komuna Fier Shegan 492 dosje

- Komuna Golem 224 dosje
- Komuna Gradishtë 392 dosje
- Komuna Karbunarë 114 dosje
- Komuna Aranitas 106 dosje
- Komuna Ngracan 17 dosje
- Komuna Selitë 35 dosje

Brenda datës 30.06.2012

2-Të merren masa për përditësimin e data base, kompletimin e të dhënave që mungojnë, rakordimin e të dhënave me informacionin e administruar në dosjet përkatëse dhe aplikimin , nëse është e mundur, të përdorimit të brendshëm online.

Brenda datës 30.06.2012

3-Të merren masa për kryerjen e inventarit për informacionin e administruar në cdo dosje, të afishohet fleta e inventarit në faqen e brendshme të dosjeve, të inventarizohen të dhënat e regjistrave dhe të bëhet kuadrimi i tyre me të dhënat e dosjeve përkatëse.

Brenda datës 31.05.2012

4-Të merren masa që , në bashkëpunim me njësitë e pushtetit vendor dhe me subjektet vetëdeklarues për legalizim, të kompletohen dosjet me të dhënat e kërkuara, dhe të përpilohen akte të marrjes së të dhënave që mungojnë për përmirësimin e procesit të legalizimit.

Brenda datës 31.05.2012

5-Në veprimet me bankën për blerjet me vlera të vogla të meren masa në përdorimin e fondeve pa i copëzuar ato me qëllim shmangien e procedurave ligjore, si në rastet e evidentuara gjatë periudhës së kontrolluar.

Vazhdimisht

6-Në lidhje me procedurat e rekrutimit të punonjësve pranë këtij institucioni të zbatohen dispozitat ligjore për Shërbimin Civil siç përcaktohet në VKM nr. 289, datë 17.05.2006.

Vazhdimisht

7- Për dosjet në process përpunimi për legalizim të ndryshohen kontratat e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore të zënë duke pasqyruar cmimin e shitjes sipas nenit 746 të “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”.

Menjëherë

8-Për dosjet në process përpunimi për legalizim, sipërfaqet e parcelave ndërtimore të zëna Brenda vijës së verdhë, mbi 300m2 deri 500m2, të pasqyruara në procesverbalet e konstatimit të përfshihen në kontratat e kalimit të pronësisë dhe të shiten me cmimin e tregut.

Vazhdimisht

9- Për dosjet në process përpunimi për legalizim, sipërfaqet e parcelave ndërtimore të zëna mbi 500 m2 jashtë vijës së verdhë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim ti bashkalidhen parcelës ndërtimore dhe të shiten me cmimin e tregut.

Vazhdimisht

10- Për kontratat e shitjes së parcelave ndërtimore, për të cilat është dhënë leja e legalizimit, të zgjidhet në rrugë gjyqësore përfshirja në cmimin e shitjes të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore të zëna mbi 300 m2 deri në 500 m2 brenda vijës së verdhë, si dhe ato mbi 500 m2 jashtë vijës së verdhë, kur nuk krijohet mundësia e parcelave ndërtimore më vete, të papërfshira në kontratën e shitjes të konfirmuara me procesverbal konstatimi nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT, Qarku Fier.

Brenda datës 31.12.2012

11-Të merren masa për përcaktimin, sipas kërkesave të manualit teknik, të rrugëve për hyrje e dalje në parcelën ndërtimore të zënë për legalizim.

Vazhdimisht

C. MASA DISIPLINORE

-Për Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t, Tiranë.

1-Mbështetur në nenin 37 e nenin 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-it, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”

1. Për z. ■■■■■, me detyrë, Drejtor i Drejtorit Rajonal të ALUIZNI-t Fier.
2. Për z. ■■■■■, me detyrë Përgjegjesi Sektorit të Hartografisë.
3. Për znj. ■■■■■, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Legalizimeve.
4. Për z. ■■■■■, me detyrë specialist në sektorin e urbanistikës dhe parcelizimit.
5. Për z. ■■■■■, me detyrë jurist, për mos plotësimin e kontratave të kalimit në pronësi të parcelave ndërtimore në përputhje me ligjin duke mos evidentuar vlerën e paguar për shitjen me rezervë por vetëm sipërfaqen e përcaktuar për legalizim.
6. Për z. ■■■■■, me detyrë specialist i financës për ndjekjen e zbatimit e detyrimeve kundrejt tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Për znj. ■■■■■. me detyrë specialiste në sektorin e legalizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t e cila ka bërë certifikimin gjatë vitit 2010.
8. Për znj. ■■■■■ me detyrë përgjegjëse e sektorit të legalizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, e cila ka nënshkruar lejet e legalizimit për secilën dosje të evidentuar.

-Për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, të ndryshuar, dhe Urdhrit nr.408, datë 12.11.2008 “Për dokumentacionin tekniko-ligjor që shoqëron vendimin e Këshillit të Ministrave për kalimin e pronësisë nga pronë shteti te poseduesi”.

-Për të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti tek posedues i ndërtimit pa leje, në Drejtorinë Qendrore e më pas për miratim në Këshillin e Ministrave.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, Agim Mandri, Irma Shkupi, Hekuran Avdulaj, Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamenti Osman Alushi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT